

Fjala përshëndetëse
Holta Zaçaj
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

I nderuar Shkëlqesia Juaj President i Republikës,
E nderuar Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Shkëlqesi Ambasadorë,
Të nderuar kolegë, miq dhe të ftuar,

Ndihem e privilegjuar sot në këtë jubile të rëndësishëm të Kushtetutës sonë, jo vetëm si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, por edhe si qytetare e këtij vendi.

Kushtetuta përfaqëson një pjesë të rëndësishme të historisë së popullit tonë, i cili me vullnet, krenari, vetëdije e besim përcolli në të aspiratat dhe vlerat që përfaqësonin ëndrrën e tij për të ardhmen, për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe të demokracisë, si edhe vizionin për t'iu bashkuar familjes evropiane.

Sot, duke nderuar Kushtetutën, këtë vepër madhore të shtetformimit shqiptar, ne nderojmë me respekt e përulësi etërit e saj, personalitetet e së drejtës, të cilët me përkushtim dhe devotshmëri përcaktuan demokracinë si destinacionin e paekuivok të rrugëtimit historik të vendit tonë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë prej 25 vjetësh është streha jonë e përbashkët e cila garanton shtetin e së drejtës dhe të drejtat tona njerëzore.

Kushtetuta përfaqëson referencën themelore dhe njësinë matëse për të verifikuar mënyrën e ushtrimit të pushteteve dhe mbrojtjen e respektimin e të drejtave dhe lirive themelore. Ajo është kryefjala e diskursit tonë të përditshëm politik e shoqëror.

Është tashmë një realitet faktik dhe i prekshëm që në nevojën për të gjetur qartësinë e së drejtës të gjithë i kthehemi tekstit të Kushtetutës, qëllimit dhe frymës së saj.

Gjykata Kushtetuese, së cilës i është ngarkuar përgjegjësia e të qenit rojtarja dhe interpretuesja e normës kushtetuese, thirret të thotë fjalën e fundit sa herë nevojitet. Ky është një mision dhe rol që gjyqtarët kushtetues e mbajnë me krenari dhe përgjegjësi të lartë.

Përmes interpretimit, Gjykata arrin ta bëjë normën kushtetuese realitet, të gjallë. Ajo në interpretimin e Kushtetutës respekton vlerat tona kombëtare si pjesë e vlerave universale, duke marrë në konsideratë qëllimin e hartuesve të saj, si edhe duke iu përshtatur dinamikave të reja shoqërore.

Gjatë tri dekadave të funksionimit të saj, Gjykata Kushtetuese ka ndikuar në zhvillimin e demokracisë dhe drejtësisë kushtetuese, e përgjegjshme për ndikimin e vendimmarrjes së saj në jetën shoqërore, ekonomike e politike të vendit.

Në këtë kuadër, vendimet e Gjykatës përbëjnë në vetvete ngjarje të një rëndësie të veçantë. Ato lypin reflektim të ndjeshmërive dhe pritshmërive të qytetarëve dhe udhëhiqen e orientohen nga e vetmja busull, Kushtetuta.

Për shkak të realitetit tonë politik e kulturës institucionale, shqetësimet për cilësinë e demokracisë, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut diktojnë shpesh nevojën për të kthyer sytë nga Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese.

Gjykata është e ndërgjegjshme jo vetëm për përgjegjësinë e saj në përmbushjen e këtij misioni të shenjtë, por edhe për koston që sjell jo rrallë kjo përgjegjësi.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi bazën e rregullave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, mbart me vete edhe mundësinë e palëve të pakënaqura.

Pavarësisht kësaj, të gjithë aktorët duhet të pranojnë verdiktin e saj. **Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është në fakt sjellja e duhur, e nevojshme dhe e vetme për të zbatuar Kushtetutën.**

Kritikat ndaj Gjykatës dhe gjyqtarëve të saj janë një indikator i lirisë së shprehjes, për të cilën ne të gjithë kemi luftuar, por deri në atë masë që nuk kthehen në sulm ose mjet presioni ndaj tyre.

Mos të harrojmë, pushteti gjyqësor mund të luajë rolin e tij kushtetues vetëm nëse është i pavarur.

Politizimi i gjyqësorit dhe gjyqësorizimi i politikës kanë qenë dhe janë fenomene, të cilat përbëjnë sfida të vazhdueshme të demokracive në zhvillim, por edhe të atyre të konsoliduara.

Reforma kushtetuese e vitit 2016, e njohur si reforma në drejtësi, synoi shkëputjen e politikës dhe të ndikimit të saj në përzgjedhjen e gjyqtarëve të lartë, duke bërë kështu një përpjekje domethënëse për depolitizimin e gjyqësorit.

Nga ana tjetër, gjyqësorizimi i politikës për shkak të referencës kushtetuese në veprimtarinë dhe proceset e politikëbërjes është një trend në rritje. **Aksionet politike të rëndësishme e kanë devijuar diskursin politik nga organi i zgjedhur nga populli në një debat gjyqësor kushtetues.**

Gjykata Kushtetuese është përfshirë tashmë në përcaktimin e çështjeve me rëndësi të madhe politike dhe shoqërore, siç janë reformat zgjedhore, territoriale, konfliktet e pushteteve dhe të kompetencave, si dhe kushtetutshmëria e nismave ligjore të ndryshme.

Gjyqësorizimi i politikës tregon në fakt, nga njëra anë, nevojën dhe rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës në interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, por, nga ana tjetër, tregon edhe rrezikun e transformimit të Gjykatës në pjesë të procesit politikëbërës.

Gjykata Kushtetuese është e përgjegjshme dhe e vetëdijshme që megjithëse nuk bën politikë, ajo ndikon në jetën politike të vendit. Në vendimet e saj Gjykata është munduar t'i shmangët aktivizmit gjyqësor në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke kontribuar përmes interpretimit pajtues në ruajtjen dhe shpëtimin e normave ligjore brenda rendit juridik, kur kjo është e mundur.

Po kështu, Gjykata ka treguar kurajë dhe profesionalizëm në ushtrim të funksionit të saj, duke shfuqizuar norma sa herë që ato nuk janë në përputhje me Kushtetutën, e ndërgjegjshme se ajo ka vetëm gomën, kurse lapsi i takon Parlamentit.

Të nderuar miq e të ftuar,

Duke kujtuar edhe një herë vlerat themelore të Kushtetutës si mësim nga e shkuara për të tashmen dhe të ardhmen, mendoj se ndajmë së bashku mirënjohjen dhe admirimin për Kushtetutën, ligjin tonë të shenjtë, me shpresë e besim se ajo do të jetë udhërrëfyesja në projektin tonë të së ardhmes evropiane.

Falemnderit!